



**KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT  
ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE**

---

*12* Shtator 2017

**Për: Znj. Sylvia Lehmann**  
Asistente  
European Commission against Racism and Intolerance (ECRI)  
Council of Europe  
F-67075 Strasbourg Cedex  
FRANCE

**Nga: Znj Erida Skëndaj**  
Drejtoreshë Ekzekutive  
Komiteti Shqiptar i Helsinkit  
Tiranë, Shqipëri

**Lënda: Observime lidhur me zbatimin e Rekomandimeve specifike nr. 3 dhe nr. 12, të Raportit të Komisionit Europian Kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI) për Shqipërinë (cikli i pestë i monitorimit) si dhe për çështje të tjera që janë në fokus të këtij Komisioni<sup>1</sup>**

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH), themeluar në vitin 1990 është organizata e parë jo-qeveritare që ushtron veprimtarinë për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në Shqipëri. Misioni i saj është të kontribuojë drejt një respektimi më të mirë të të drejtave të njeriut, forcimin e shtetit të së drejtës dhe mbajtjen e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme, në përputhje me Kushtetutën, të drejtën ndërkombëtare dhe ligjet. Një nga fushat e veprimtarisë së KShH-së është mbikqyrja dhe vëzhgimi i respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut nga institucionet shtetërore, me fokus të veçantë grupet në nevojë, ku përfshihen dhe shtetasit që diskriminohen ose vendosen në kushte të pabarabarta me të tjerët për shkak të racës, origjinës kombëtare/etnike, ngjyrës, shtetësisë, fesë dhe gjuhës (i njohur ndryshe si diskriminimi racia).

Republika e Shqipërisë ka ratifikuar disa konventa ndërkombëtare të cilat ndalojnë racizmin, diskriminimin racia, ksenofobinë dhe intolerancën.

Në kuadër të ciklit të pestë të monitorimit, Raporti i Komisionit Europian Kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI) për Shqipërinë<sup>2</sup> është miratuar në muajin Mars 2015 dhe është botuar në Qershor 2015. Në raport<sup>3</sup>, janë trajtuar katër tema të përbashkëta për të gjitha shtetet anëtare të KE: (1) çështjet legjislative, (2) gjuha e urrejtjes, (3) dhuna, (4) politikat e

---

<sup>1</sup> Ky raportim kryhet në kuadër të projektit "Respektimi më i mirë i të drejtave të njeriut përmes forcimit të Shtetit të së Drejtës" (Klinika Ligjore XI), mbështetur nga Civil Rights Defenders

<sup>2</sup> Republika e Shqipërisë është pranuar si anëtare e Këshillit të Europës në vitin 1995

<sup>3</sup> Raporti pasqyron gjendjen në Shqipëri deri në datën 10 Dhjetor 2014



## KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

integritimit dhe disa tema specifike të lidhura me secilën prej tyre. Sipas Raportit të mësipërm, rekomandimet specifike për të cilat ECRI kërkon zbatimin me përparësi nga autoritetet shqiptare janë:

**Rekomandimi A** - Autoritetet të sigurojnë akses efektiv në drejtësi për viktimat e diskriminimit nëpërmjet një sistemi ndihme ligjore funksionale dhe të financuar siç duhet.

**Rekomandimi B** - Autoritetet të sigurojnë që të gjithë romët, si dhe personat e tjerë të cilët mund të jenë dëbuar nga shtëpitë e tyre, të gëzojnë të gjitha garancitë e parashikuara nga tekstet ndërkombëtare në këtë drejtim; ata duhet të njoftohen paraprakisht për aktivitetet e planifikuara dhe të përfitojnë nga mbrojtja e duhur ligjore; dhe ata nuk duhet të dëbohen pa mundësinë e ristrehimit në akomodim të denjë.

Lidhur me Rekomandimin A, KShH vëren se, një përqindje e konsiderueshme<sup>4</sup> e ankesave të adresuara nga qytetarët pranë KShH-së lidhen me kërkimin e shërbimit ligjor falas, veçanërisht këshillim ligjor falas apo përfaqësim ligjor në gjykatë, nga shtetas të burgosur, nga persona që u përkasin pakicave kombëtare<sup>5</sup>, kryesisht Komuniteti Rom, etj.

10.7 % e ankesave drejtuar KShH-së gjatë vitit 2016 vijnë nga shtetas që i përkasin Komunitetit Rom dhe Egjiptian. Ankuesit pretendojnë kryesisht cenim të së drejtës për jetë private dhe familjare dhe të drejtës për të mos u diskriminuar. Këta shtetas ankohen gjithashtu se nuk janë në gjendje të përballojnë kostot financiare për të marrë ndihmën ligjore nga avokatë privatë. KSHH dhe disa OJF të tjera kanë vazhduar të kontribuojnë në këtë drejtim, të mbështetur nga donatorë të ndryshëm. Avokatët e caktuar kryesisht nga shteti në proceset penale ku janë të pandehur shtetas që i përkasin grupeve në nevojë, shpesh e kryejnë detyrën e mbrojtësit në mungesë cilësie, profesionalizmi apo në mënyrë fiktive.

Komisioni Shtetëror për Ndihmën Juridike pranë Ministrisë së Drejtësisë, për shtetasit në pamundësi financiare vazhdon të jetë jo-efiçent dhe me mungesë të burimeve të nevojshme financiare për të ofruar shërbime ligjore falas për një numër të konsiderueshëm shtetasish që janë në nevojë.

Në kuadër të reformës në Sistemin e Drejtësisë është duke u hartuar një projektligj i ri për ndihmën juridike, për të cilin janë zhvilluar disa seanca konsultimi me grupet e interesit.

2. Lidhur me Rekomandimin B, në muajt Prill—Qershor 2016, KShH trajtoi ankesat e shtetasve të Komunitetit Rom që banonin në rrugën "Irfan Tomini", Bashkia Tiranë, të cilët u ankuan se, banesat e tyre të ndërtuara në periudhën 1986-1990, janë prishur nga Inspektoriat i Mbrojtjes së Territorit në dt. 18 Shkurt 2016, për shkak të ndërtimit të segmentit rrugor "Komuna e Parisit – Rruga e Kavajës".

<sup>4</sup> 15 % e ankesave adresuar KShH për vitin 2015

<sup>5</sup> 11% e ankesave adresuar KShH për vitin 2016 nga persona që i përkasin pakicave kombëtare, kryesisht persona nga komuniteti Rom



## KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Për verifikimin e këtyre ankesave, KShH ka mbajtur korrespondencë zyrtare me Bashkinë Tiranë nga e cila ka rezultuar se, Bashkia Tiranë nuk ka zbatuar VKM nr. 608, dt. 5.9.2012, *“Për përcaktimin e procedurës së kalimit të pronësisë së pasurive të paluajtshme, të ndërtuara deri më 10.8.1991, e të truallit funksional të tyre, kur nuk posedohen akte fitimi pronësie, si dhe për regjistrimin e tyre”*, i ndryshuar. Si pasojë, me ndërhyrjen e Inspektoriatit Kombëtar për Mbrojtjen e Territorit, në muajin Shkurt 2016 janë prishur banesat e disa familjeve Rome. Sipas VKM-së së përmendur në këtë paragraf, Bashkia Tiranë detyrohej si *“institucion i autorizuar”* për kryerjen e procedurave përkatëse ligjore për kalimin në pronësi të pasurive të paluajtshme që plotësonin kriteret ligjore. Pas regjistrimit në emër të pronarëve të tyre, këto banesa mund të shpronësoheshin sipas ligjit, për interes publik, për ndërtimin e segmentit rrugor *“Komuna e Parisit – Rruga e Kavajës”*.

Me anë të një Shkrese zyrtare drejtuar Bashkisë Tiranë<sup>6</sup>, KShH tërhoqi vëmëndjen se, mosveprimi i Bashkisë Tiranë dhe që ka cuar në prishjen e banesave, ka shkelur të drejtat themelore të disa familjeve Rome, banorë të zonës së Selitës, Tiranë, si dhe ka vështirësuar kushtet e jetesës në të cilat jetonte ky komunitet. Çështja në fjalë është ndjekur dhe nga institucioni i Avokatit të Popullit, i cili në përfundim ka rekomanduar fillimin e hetimit për veprën penale *“Shpërdorim detyre”*, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 248 e 25 të Kodit Penal, ndaj inspektorëve të Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, të cilët kanë marrë pjesë në prishjen e banesave të anëtarëve të Komunitetit Rom<sup>7</sup>.

3. Procesi i grumbullimit të mbetjeve të riciklueshme (bidonë plastikë, kanaçe, enë alumini, etj) si i vetmi burim jetese për qindra e mijëra familje që i përkasin komuniteteve Rome dhe Egjiptiane është shoqëruar me ankesa të shumta nga këta shtetas ndaj Policisë Bashkiake Tiranë për sjellje diskriminuese, duke cënuar dinjitetin dhe shpesh integritetin fizik të tyre.

Pretendimet për diskriminim (të hershëm) të anëtarëve të minoritetit Rom nga Bashkia Tiranë janë trajtuar edhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD), i cili i ka dërguar një Rekomandim Bashkisë Tiranë<sup>8</sup>. Aty thuhet se, diskriminimi është shkaktuar nga pengimi i anëtarëve të këtij komuniteti për të grumbulluar materialet e riciklueshme si dhe në bllokimin e mjeteve të punës (*motorra, tricikël, etj*) si mjete pune. Duke patur parasysh gjëndjen ekonomike të komunitetit Rom, kushtet në të cilat jetojnë dhe mënyrën e sigurimit të të ardhurave, KMD i ka rekomanduar Bashkisë Tiranë, punësimin e këtij komuniteti brenda aktiviteteve private të liçensuara, në mënyrë që të krijohen kushtet për të siguruar jetesën bazuar në veprimtari të ligjshme për familjet rome. Gjithashtu, Bashkisë i është rekomanduar ofrimi i ndihmës ekonomike për këto familje, banorë të Bashkisë Tiranë.

Tre vjet nga Rekomandimi specifik i KMD-së, mes palëve, Drejtoria e Përgjithshme nr. 1, e Punëtorëve të Qytetit dhe Bashkisë Tiranë si dhe operatorëve privatë *“I. B. Recycling”* shpk dhe *“3 R”* shpk është lidhur Akt-Marrëveshja nr. 21469, dt. 15.12.2015 *“Mbi*

<sup>6</sup> Shkresa nr. 291-291/2, dt. 13 Maj 2016, e KShH

<sup>7</sup><http://www.avokatipopullit.gov.al/sites/default/files/REKOMANDIME/VITI2016/18.04.2016%20REKOMANDIM.pdf>

<sup>8</sup> Shkresë nr. 282/1, dt. 23.07.2012, e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi drejtuar Bashkisë Tiranë



## KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

punësimin e individëve që mbledhin materiale të riciklueshme nëpër qytet, dhe seleksionimin e këtyre materialeve para se të futen në zonën e asgjësimit të tyre.”

Megjithëse objekti i kësaj Marrëveshjeje formalisht është punësimi i individëve që mbledhin materiale të riciklueshme dhe seleksionimi i tyre para se të futen në zonën e asgjësimit, nga përmbajtja e saj rezulton se, ajo rregullon në mënyrë të detajuar mënyrën e ushtrimit të aktivitetit të operatorëve (subjekteve) tregtare që mbledhin dhe riciklojnë mbetjet e riciklueshme në Bashkinë Tiranë.

Në Pikën 3.1.2, të Akt-Marrëveshjes thuhet se: *“Operatori 3 R...merr përsipër të punësojë sipas legjislacioneve në fuqi personat e interesuar për t’u punësuar si punëtorë për të mbledhur mbetjet e riciklueshme.”* Në këtë nen, togfjalëshi *“merr përsipër të punësojë sipas legjislacioneve në fuqi personat e interesuar”* është fakultativ dhe i përgjithshëm. Mungesa e parashikimit konkret të një plani për punësimin e anëtarëve të Komuniteteve Rome dhe Egjiptiane do të thotë që mungojnë veprimet e natyrës pozitive, të parashikuara në nenin 11, të Ligjit «Për Mbrojtjen nga Diskriminimi», të cilat synojnë përshpejtimin e vendosjes reale të barazisë. Përdorimi i termit *“persona të interesuar”* i lë hapësirë të gjerë subjektit tregtar për të punësuar ose jo anëtarë të këtyre grupeve dhe nuk targeton në mënyrë të veçantë individët që janë në kushte të vështira sociale – ekonomike, veçanërisht ata që vijnë nga radhët e Komunitetit Rom dhe Egjiptian.

Në Pikën 3.1.9, të Akt-Marrëveshjes thuhet se: *“Operatori 3 R”, në bashkëpunim me sektorin e riciklimit brenda një periudhë 3-6 muaj duhet të largojnë çdo individ që mbledh në mënyrë të jashtëligjshme mbetjet në kazanët nëpër qytet.”* Autoriteti për të larguar individët që mbledhin mbetjet në kazanët në qytet nuk mund t’i delegohet një subjekti tregtar apo privat, për rrjedhojë, është e paligjshme. Zbatimi i kësaj Pike mund të sjellë përplasje fizike apo verbale mes subjektit dhe shtetasve në fjalë.

Arbitrariteti i Akt-Marrëveshjes së mësipërme vijon edhe në Pikën 3.2.4, të saj, ku operatori I. B. Recycling sh.p.k. merr përsipër *“të punësojë punëtorë që mbledhin mbetje të riciklueshme të tipit elektrike-elektronike sipas nevojave të tij”*. Duke vendosur këtë kusht, marrëveshja synon interesin ekonomik të subjektit tregtar dhe nuk merr në konsideratë nevojat social-ekonomike të mbledhësve individuale që i përkasin grupeve në nevojë.

Avokati i Populli ka monitoruar gjatë vitit 2016 gjëndjen e pjestarëve të Komunitetit rom dhe egjiptian që jetojnë duke shitur mbetjet e riciklueshme, të cilëve, në mënyrë të vazhdueshme u bllokohen këto materiale nga Policia Bashkiake Tiranë. Në Rekomandimin me nr. K3/146-2 Prot., dt. 22.07.2016, drejtuar Bashkisë Tiranë, Avokati i Popullit ka konstatuar se, bllokimi nga ana e Bashkisë, të materialeve të riciklueshme që mbledhen nga persona në nevojë, kryesisht pjestarë të komunitetit rom dhe egjiptian në kushtet kur atyre nuk u ofrohet asnjë zgjidhje alternative për sigurimin e mjeteve thelbësore të jetesës së familjave të tyre apo në kushtet kur nuk u ofrohen dhe sigurohen programe punësimi të përherëshme dhe me baza të qëndrueshme do të ishte me pasoja të rënda dhe fatale për ta. Sipas Avokatit të Popullit, praktikat e fundit të ndjekura nga Bashkia Tiranë ndikojnë në përkeqësimin e situatës së përgjithshme dhe kushteve të jetesës së banorëve të komunitetit Rom dhe Egjiptian. Për Avokatin e Popullit, është i papranueshëm sekuestrimi dhe bllokimi i mbetjeve të riciklueshme pa asnjë procedurë apo lëshuar asnjë akt respektiv nga strukturat e Bashkisë Tiranë ndaj individëve që kanë shpenzuar kohë dhe energji për



## KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

mbledhjen e tyre, me qëllimin e vetëm të sigurimit të të ardhura familjare ditore, pasi nuk gjejnë nga strukturat shtetërore asnjë mbështetje apo përfshirje në programet sociale.

Për këto arsye, Avokati i Popullit i ka rekomanduar Bashkisë Tiranë, të marrë masa të menjëhershme për ndërprerjen e praktikave për bllokimin e materialeve të riciklueshme që mbliidhen nga persona në nevojë, kryesisht pjestarë të komunitetit rom dhe egjiptianë.

Në reagimin publik të dt. 10 gusht 2016 mbi ngjarjen tragjike ku një i mitur 17 vjeçar u gjend pa jetë në vendin e derdhjes dhe përpunimit të mbetjeve në qytetin e Tiranës (Landfilli i Sharrës), ndër të tjera, KShH rekomandoi që alternativat e punësimit që u ofrohen shtetasve të Komuniteteve rom e egjiptiane duhet të jenë të sigurta për jetën dhe shëndetin e tyre dhe t'i përgjigjen nevojave ekonomike të tyre dhe familjarëve të mitur apo të moshuar që kanë në ngarkim. Në muajin Prill 2016<sup>9</sup>, KShH iu drejtua me shkresë zyrtare Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi duke kërkuar kryerjen e një hetimi administrativ ex-officio të këtij institucioni, nëse ndalimi i këtij aktiviteti individual për këta shtetas përbën qasje diskriminuuese apo jo, duke marrë në konsideratë faktin se pasojat mund të jenë shumë të dëmshme pasi do të ndërpriste mundësinë e vetme për të siguruar të ardhura për këto familje dhe do të përkeqësonte jetën e përditshme të antarëve të këtij Komuniteti, të cilët jetojnë në kushte të mjerueshme. Madje shumica e tyre nuk kanë një strehë të sigurtë, pasi një numër i konsiderueshëm i familjeve të Minoritetit rom e Komunitetit egjiptian në zonën e Bregut të Lumit, Bashkia Tiranë u shpërngulën forcërisht nga strehëzat (baraket) ku jetonin për shkak të punimeve në infrastrukturën publike, por pa garantuar efektivisht dhe në kohë programe strehimi të pranueshme dhe të përbalueshme për të gjithë të prekurit, duke cënuar thelbin e të drejtës për jetë të qetë private dhe familjare, për një pjesë prej tyre. Për këtë shkresë, KShH nuk ka marrë përgjigje nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi si një institucion *quasi gjyqësor*, i cili duhet të veprojë me efikasitet dhe shpejtësi.

Në muajin Dhjetor 2016, pranë KShH është adresuar një ankesë që kishte të bënte me pretendimin për ushtrim dhune nga punonjësve të Policisë Bashkiake Tiranë ndaj një banori me qëllim që të bllokoni mjetin e levizshëm (motorr) si dhe materialet e ricikluara (bidonë, etj), që ai po transportonte. Shtetasi 31 vjeçar, me tre fëmijë, nga komuniteti Rom ka qënë duke kaluar në Rrugën "Siri Kodra", rreth orës 20.00 në darkë, me motorrin e tij të ngarkuar me bidonë plastike. Ai pretendon se është ndaluar nga disa punonjës të Policisë Bashkiake të Bashkisë Tiranë, të cilët i kanë thënë se motorri me të cilin po qarkullonte do të bllokohet. Ankuesi i ka thënë se mund të marrin materialet e ricikluara që kishte me vete por jo motorrin. Meqënëse ai nuk ka dashur t'i dorëzojë motorrin, mes tij dhe punonjësve të Policisë Bashkiake ka patur një përplasje fizike. Shtetasi pretendon se është shtyrë dhe qëlluar nga punonjësit e Policisë Bashkiake dhe është përplasur me një mur ose shtyllë. Nga përplasia është çarë në vetullën e syrit të majtë. Më pas, dikush e ka shoqëruar në Spital ku i është qepur dhe mjekuar plaga. Në një video të publikuar në internet shihet ky shtetas me një fashë të bardhë, të vendosur në vetullën e syrit të majtë<sup>10</sup>.

Shenjat e qepjes në vetullën e ankuesit i kanë konstatuar edhe vëzhgues të KShH-së, gjatë takimit me këtë shtetas në dt. 16.12.2016, në Rrugën "Siri Kodra". Ky shtetas deklaroi se nuk do të bëjë denoncim, pasi nuk dëshiron të ketë probleme me Policinë e Shtetit. Për

<sup>9</sup> Shkresa nr. 378-378/1-378/2, e KShH

<sup>10</sup> <http://shuplaka.com/policia-bashkiake-dhunon-te-riun-komuniteti-rom-nis-protestat-video/>



## KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

verifikimin e ankesës së mësipërme, në këtë datë, KShH zhvilloi një takim me Zv. Drejtorin e Policisë Bashkiake pranë Bashkisë Tiranë, i cili tha se, nuk kishte asnjë informacion për ushtrim dhune apo tejkallim të përdorimit të forcës ndaj shtetasit në fjalë nga punonjësit e Policisë Bashkiake. Me Shkresën nr. 14-14/1, dt. 16 Janar 2017, “Mbi trajtimin e pretendimit për ushtrim dhune fizike ndaj shtetasit Shkëlqim Qerimi, nga përplasja me punonjësit e Policisë Bashkiake Tiranë”, të KShH drejtuar Policisë Bashkiake Tiranë, KShH referoi zyrtarisht rastin për trajtim duke rekomanduar se, kryerja e veprimeve nga ana e punonjësve të Policisë Bashkiake duhej bërë në përputhje me kriteret ligjore, duke respektuar dinjitetin dhe paprekshmërinë fizike të shtetasit. Përdorimi i tepruar i forcës duke shkaktuar dëmtime në formën e çarjes së vetullës së syrit të majtë të ankuesit konsiderohet i paligjshëm. KShH<sup>11</sup> kërkoi marrjen e masave për verifikimin e këtij rasti si dhe informimin me atë çka do të konkludonte nga ky verifikim.

Në përgjigje të saj, me Shkresën nr. 1812/1, dt. 31.01.2017, “Kthim përgjigje” drejtuar KShH, Policia Bashkiake Tiranë ka mohuar plotësisht mundësinë e dhunës fizike ndaj ankuesit. Sipas kësaj Shkrese, Policia Bashkiake i konsideron mbledhësit individualë Romë dhe Egjyptianë si qytetarë të papërgjegjshëm, që vjedhin dhe dëmtojnë vazhdimisht kontenierët, madje u vënë edhe zjarrin.

KShH, në bashkëpunim me European Roma Rights Center do të paraqesë një Kërkesë-padi në gjykatë, për ndalimin e diskriminimit ndaj disa shtetasve, mbledhës individualë të materialeve të riciklueshme që i përkasin minoritetit Rom, për shkak të mungesës së caktimit të minimumit jetik me akte ligjore dhe nënligjore si dhe veprimeve të dhunshme fizike dhe ofendimeve me bazë raciale nga ana e organeve shtetërore. Kjo çështje do ndiqet në formën e litigimit strategjik dhe synon rivendosjen e të drejtave të shkelura.

4. Gjatë periudhës Tetor – Nëntor 2016, bashkë me aktivistë të komunitetit Rom, KShH ka realizuar disa misione monitorimi tematike mbi respektimin e të drejtës së jetës dhe shëndetit, arsimit, strehimit dhe punësimit të këtyre komuniteteve në bashkitë Durrës, Fier, Berat dhe Shkodër. Monitorimet janë realizuar në zonën e Nish-Tullës dhe Shkozet, bashkia Durrës, në fshatin Driz të Fierit, në lagjen “Donika Kastriot” dhe “Ish-Pjeshkore”, në bashkinë Berat, në zonën pranë Prokurorisë të Gjykatës së Shkallës së Parë, bashkia Shkodër, si dhe në zonën e quajtur “Ish magazinat”, në Fushë-Krujë.

Nëpërmjet intervistimit të një pjese të banorëve të komunitetit rom dhe egjyptian, vëzhgimit fizik të kushteve infrastrukturore të vendbanimit të tyre, si dhe takimit me përfaqësues të institucioneve përkatëse vendore apo qëndrore, rezultuan disa problematika që i vlerësojmë me rëndësi për t’i adresuar në vijim.

a) Gjatë kontaktit me banorët e këtyre komuniteteve u vërejt se ata nuk kishin informacion në lidhje me kompetencat e institucioneve përgjegjëse pranë të cilave mund të kërkohen të drejtat për strehim, arsimim, shërbim shëndetësor dhe punësim.

b) Pavarësisht fushatave të vaksinimit të fëmijëve të komunitetit rom nga DRShP-të, nga verifikimi rezultoi se ende vijon të jenë të pavaksinuar një përqindje e ulët e tyre. Kjo vjen edhe si pasojë e mungesës së ndërgjegjësimit të shtetasve të këtij komuniteti.

<sup>11</sup> Me Shkresën nr. 14-14/1, dt. 16 Janar 2017, të KShH drejtuar Policisë Bashkiake Tiranë, për dijëni, Kryetarit të Bashkisë Tiranë



## KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

KShH sugjeroi që, Ministria e Shëndetësisë, DRShP-të në bashkëpunim me bashkitë përkatëse, të ndërmarrin fushata ndërgjegjësuese mbi higjenizimin, vaksinimin dhe kujdesin shëndetësor në përgjithësi, pranë vendit ku banon komuniteti rom, për të parandaluar rastet e mundshme epidemike apo sëmundje të rënda infektive.

c) Një numër relativisht i vogël i shtetasve të Komuniteteve rome dhe egjiptiane punonin në sektorin e biznesit fason apo ndërmarrjen e pastrimit, veçanërisht në bashkinë Berat. Ndërkohë shumica e personave të aftë për punë punonin si mbledhës individualë të mbetjeve urbane, të pasiguruar në kontributet shoqërore dhe shëndetësore dhe në rrezik potencial për t'u infektuar me sëmundje të ndryshme. Papunësia e personave të aftë për punë në komunitetin rom dhe egjiptian konstatohet në nivele të larta, edhe për shkak të mungesës së arsimit të nevojshëm. Në Bashkinë Berat rezultoi mungesa e qendrës për ofrimin e kurseve të formimit profesional ndërsa në bashkitë e tjera, punësimi i tyre ka qenë në nivele të ulëta pavarësisht ofrimit të kurseve profesionale.

Bashkëndimi i politikave dhe masave ndërmjet Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, bashkive dhe Zyrave Rajonale të Shërbimit Kombëtar të Punësimit në drejtim të garantimit efektiv apo rritjes së numrit të kurseve të formimit profesional ndaj punëkërkuessve të komunitetit rom dhe egjiptian, si dhe orientimit mbi tregun e punës do të lehtësonte ndërmjetësimin dhe punësimin efektiv dhe të përshtatshëm të këtyre komuniteteve. Njëkohësisht kjo do të shmangte barrën fiskale të ndihmës ekonomike ndaj këtij komuniteti.

d) Mungesa e kanalizimeve të ujërave të zeza, ekzistenca pranë banesave të gropave septike, mungesa e ujit të pijshëm apo kushtet infrastrukturore të amortizuara brenda dhe jashtë banesave të banorëve që i përkasin komuniteteve egjiptiane dhe rome në të gjitha zonat e monitoruara, si dhe kanalet e ndotura me rrezik për shtimin e insekteve apo kafshëve të tjera në zonën e "Ish Pjeshkore" Berat, konstatohen probleme thelbësore që cenojnë cilësinë minimale të jetesës. KShH sugjeroi që, bashkitë përkatëse të adresojnë sa më shpejt të jetë e mundur çështjet, duke rritur apo orientuar investimet publike në kanalizime të ujërave të zeza, të infrastrukturës rrugore dhe higjenizimin apo sistemimin e kanaleve pranë banesave, për të garantuar nivelin minimal të jetesës dhe shëndetit të komunitetit.

e) Pjesa më e madhe e anëtareve të Komuniteteve rome dhe egjiptiane në bashkitë e monitoruara nuk kanë aplikuar për banesa sociale me qera apo bonuse strehimi, për shkak se nuk plotësonin kriteret ligjore për të përfutuar nga këto programe. Në kontrast me faktin e mosplotësimin të këtyre kriterëve ligjore paraqitet nevoja e lartë jetike e këtij komuniteti për të patur një banesë të përshtatshme për të jetuar. Në mënyrë të veçantë, KShH vërejt një numër të konsiderueshëm rastesh jetese në të njëjtën strehë, të familjeve Rome të cilat përbëheshin nga një numër tepër i lartë pjesëtarësh. Në disa raste, kushtet e jetesës në këto strehëza apo edhe çadra të improvizuara ishin tepër të këqija.

KShH vëren se, nga banesat sociale të ndërtuara nga Bashkitë në bashkëpunim me Ministrinë e Zhvillimit Urban kanë përfutuar një numër i vogël familjesh egjiptiane. Në Bashkinë Berat nuk kishte asnjë projekt për rikonstruksionin e 25 banesave të komunitetit të vizituar që kishte nevojë për të tilla ndërhyrje. Në Bashkinë Krujë kishte pretendime për diferencime në rikonstruksionin e disa banesave sipas projektit të mbështetur nga Ministria



## KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

e Zhvillimit Urban, ndërsa në Bashkinë Fier nuk disponohej asnjë informacion mbi numrin e përfituesve të komuniteteve romë apo egjiptiane nga ndërtimi i banesave sociale me qera.

KShH sugjeroi që, bashkitë të adresojnë efektivisht çështjen e strehimit të komuniteteve romë dhe egjiptiane, me qëllim planifikimin e saktë të nevojave për banesa sociale në të ardhmen të këtyre komuniteteve. Në këtë drejtim inkurajohen masat pozitive për të rikonstruktuar banesat e amortizuara ku jeton një pjesë e këtyre komuniteteve.

Në Kuvendin e RSH është depozituar nga Këshilli i Ministrave një nismë ligjore që parashikon një ligj të ri për strehimin social (ende në proces). Qëllimi i këtij projektligji është krijimi i një kuadri ligjor të ri për ofrimin e strehimit social dhe të procesit administrimit dhe planifikimit të programeve sociale në këtë fushë. Projektligji parashikon programe të reja të strehimit social, mundësinë e subvencionimit deri në 100% të qirasë, dhe përcaktimin e përgjegjësive specifike për institucionet publike në nivel qendror dhe vendor në lidhje me ofrimin e këtyre shërbimeve.

KShH ka paraqitur oponencë ligjore për këtë projektligj edhe sa i takon çështjeve që kanë të bëjnë me programet e strehimit të Komunitetit Rom dhe Egjiptian. Kështu, në nenin 12 paragrafi 1 të projektligjit, parashikohen kushtet për fitimin e statusit të përfituesit nga programet sociale të strehimit, ku ndër të tjera parashtrohet si kusht që individët/familjet përfituese janë ato të regjistruara në zyrat e gjendjes civile në njësitë e vetëqeverisjes vendore. KShH adresoi pranë Kuvendit se, në një pjesë të rasteve, anëtarët e komunitetit rom dhe egjiptian nuk janë të regjistruar në zyrat e gjendjes civile, dhe për pasojë mund t'u mohohet e drejta për të marrë pjesë në programet e strehimit. Në nenin 17, të projektligjit, ku përpunohen shprehimisht procedurat e zhvendosjes citohet vetëm se subjekti duhet që të njoftohet para shpërnguljes, por nuk parashikohet shprehimisht detyrimi për konsultim. Ky detyrim rrjedh nga Pakti për të Drejtat Ekonomike Shoqërore dhe Kulturore dhe në veçanti neni 11 tij. Ky detyrim rrjedh edhe nga interpretimi i Paktit në Komentin e Përgjithshëm Nr. 7 mbi "Strehimin e përshtatshëm" të Komitetit Ekonomik Shoqëror dhe Kulturor të OKB-së gjithashtu, po ashtu edhe nga standardet e përpunuara nga Komiteti Evropian për të Drejtat Sociale. Për këtë arsye, KShH sugjeroi që, në nenin 17 të shtohet se, procedurat e zhvendosjes, duhet të bëhen, inter alia, duke respektuar të drejtën e komunitetit përkatës, ose individëve, për t'u konsultuar paraprakisht. Është pozitive fakti se, në nenin 17 paragrafi 3, të projektligjit specifikohet se kur shikohet e nevojshme, mund të akordohet ndihmë juridike për personat që vendosin të kundërshtojnë gjyqësisht zhvendosjen. Projektligji është ende në procedurë parlamentare dhe pritet të miratohet nga Kuvendi i ri që është konstituuar nga zgjedhjet e dt.25 Qershor 2017<sup>12</sup>.

f) Nga monitorimi rezultoi se, një numër i konsiderueshëm të miturish nuk ndjekin arsimin bazë të detyrueshëm të parashikuar në Ligjin nr. 69/2012 "*Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar.

KShH sugjeroi ngritjen e një grupi pune të posaçëm ndërsektorial me përfaqësues nga Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe institucioneve të tjera vendore apo qendrore në nivel lokal, për vëzhgimin në terren të situatës së arsimit të Komuniteteve romë dhe egjiptiane. Në këtë mënyrë do të evidentohen rastet individuale të braktisjes së shkollës apo

<sup>12</sup> <https://www.parlament.al/projektligj/projektligj-per-strehimin-social/>





## KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

mosfrekuentimit të rregullt të saj si dhe mund të mundësohej gjithashtu, regjistrimi i menjëhershëm në shkollat e arsimit bazë të detyrueshëm të këtyre të miturve, bazuar në këtë Ligj.

Adresimit institucional të problematikave të evidentuara më sipër, të konstatuara gjatë monitorimit të KShH-së, iu përgjigj pozitivisht vetëm Ministria e Arsimit dhe e Sporteve, duke u angazhuar për vëmendje të shtuar në drejtim të përmirësimit të situatës në fushën e arsimit të detyrueshëm.

5. Në vëmendje të KShH-së ka qenë edhe trajtimi i rasteve ku është pretenduar diskriminim për shkak të orientimit seksual. Pas ankesës së ardhur, KShH ka paraqitur një Ankesë zyrtare<sup>13</sup> drejtuar Drejtorit të Policisë së Shtetit, për dijëni, Shërbimit të Kontrollit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave në Ministrinë e Punëve të Brendshme, për sjellje diskriminuese ndaj anëtarëve të komunitetit LGBTI nga ana e punonjësve të Policisë Rugore të Komisarariatit të Policisë Shkodër, pas ndalimit të tyre nga policia në dt. 19.01.2016. Me Shkresën nr. 121, dt. 19.02.2016, të Shërbimit të Kontrollit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave në Ministrinë e Punëve të Brendshme drejtuar KShH, ka rezultuar se, pas verifikimit të rrethanave të ngjarjes është sugjeruar fillimi i hetimit disiplinor nga Drejtoria e Standarteve Profesionale në Policinë e Shtetit, për një punonjës të policisë të patrullës së përgjithshme të Komisarariatit të Policisë Shkodër, për shkak të shkeljes së normave të etikës në komunikim pasi kishte përdorur shprehje me karakter diskriminues ndaj shtetasit Fatjon Hoxha (i thirrur Anxhela), anetar i komunitetit LGBTI.

6. Ministria e Punëve të Jashtme ka ngritur një grup pune duke synuar hartimin e një ligji gjithëpërfshirës për mbrojtjen e minoriteteve. Kjo ministri ka realizuar disa procese konsultimi me përfshirjen edhe të shoqatave të minoriteteve, organizatave të shoqërisë civile dhe organizmave ndërkombëtarë. Disa prej këtyre komuniteteve kanë reaguar për një zgjerim të karakteristikave mbi bazën e të cilave akordohet statusi i minoritetit, duke referuar në Konventën Kuadër për Mbrojtjen e Minoriteteve.

Përsa më sipër, KShH shpreson që ky informacion t'i shërbejë monitorimit dhe zbatimit më efektiv të luftës kundër racizmit dhe intolerancës, rritjes së bashkëpunimit dhe ndërveprimit mes autoriteve shtetërore, në funksion të respektimit më të mirë të të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve pa dallime racore, të origjinës kombëtare ose shoqërore, përkatësisë në një minoritet kombëtar, etj.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin e deritanishëm!

Me konsideratë,

Erida Skëndaj

Drejtoreshë Ekzekutive  
Komiteti Shqiptar i Helsinkit

<sup>13</sup> Me Shkresën nr. 25, dt. 22 janar 2016, të KShH